



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E  
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:  
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “AGROBIZNES”**

**(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)**

**Tiranë, 2024**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “Agrobiznes”, me strukturë 2+2, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Ekonomi-bujqësore”, Niveli II i KSHK-së (klasa e 10-të dhe 11-të);;
- programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Agrobiznes”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 12-të dhe 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësit dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të “Teorisë profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “Agrobiznes” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale.

Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Agrobiznes**“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e bujqësisë	52 orë	15
2	Ekonomi ferme	62 orë	19
3	Bazat e bujqësisë organike	45 orë	13
4	Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave	53 orë	16
5	Ligjshmëria dhe marketingu bujqësor	63 orë	19
6	Kontabiliteti në ekonomitë bujqësore	60 orë	18
	<b>TOTALI</b>	<b>335 orë</b>	<b>100%</b>

Temat sipas lëndëve janë:

**a) Bazat e bujqësisë”, kl. 10:**

**(52 orë)**

- Bimët dhe mjedisi 8 orë
- Rritja dhe zhvillimi i bimëve 8 orë
- Shumëzimi i bimëve 8 orë
- Toka bujqësore 12 orë
- Plehërimi i bimëve 8 orë
- Njohuri të përgjithshme për mbrojtjen e bimëve 8 orë

**b) Ekonomi ferme”, kl. 10 dhe 11:**

**(62 orë)**

- Njohuri për fermën 12 orë
- Financimi nga kapitali i vet 12 orë
- Financimi nga kapitali i të tretëve 12 orë

• Tregu dhe shpërndarja e produkteve bujqësore e blegtorale	6 orë
• Qarkullimi i pagesave	10 orë
• Shpenzimet në ferma	10 orë
<b>c) “Bazat e bujqësisë organike”, kl.12:</b>	<b>(45 orë)</b>
• Burimet natyrore dhe administrimi i tyre	10 orë
• Agroteknologjia e prodhimit organik	12 orë
• Organizmat e modifikuara gjenetikisht ( <i>OMGJ</i> )	2 orë
• Mbarështrimi organik i kafshëve. Akuakultura organike	7 orë
• Projektimi i fermës së prodhimit organik	8 orë
• Legjislacioni dhe rregullat e certifikimit dhe tregëtimit të prodhimeve <i>BIO</i>	6 orë
<b>d) “Përmirësimi uJOR dhe sistemimi i tokave”, kl. 12:</b>	<b>(53 orë)</b>
• Faktorët që ndikojnë në përmirësimin uJOR dhe marrëdhëniet tokë-ujë-bimë	8 orë
• Norma agronomike e ujitjes dhe cilësia e ujit për ujitje	7 orë
• Mënyrat e ujitjes	9 orë
• Nevojat për kullim, filtrimi dhe matja e nivelit të ujit nëntokësor	7 orë
• Rrjetet kulluese dhe drenazhimi	9 orë
• Gërryerja e tokës nga uji dhe era dhe faktorët ndikues të saj	4 orë
• Sistemimi sipërfaqësor kurriz dhe rrafsh i tokave bujqësore	9 orë
<b>e) “Ligjshmëria dhe marketingu bujqësor”, kl. 12 dhe 13:</b>	<b>(63 orë)</b>
• Prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë	7 orë
• Bashkëpronësia dhe shpronësimi	11 orë
• Kontratat llojet e kontratave	5 orë
• Qeraja e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave	3 orë
• Llojet dhe format ligjore të bizneseve në ekonomi bujqësore.	4 orë
• Marrëdhëniet juridike të të punësuarve në ekonomi bujqësore.	2 orë
• Kuadri ligjor dhe normativ që vepron në ekonominë bujqësore.	4 orë
• Mjedisi marketing	6 orë
• Sjellja konsumatore	5 orë
• Produkti dhe llojet e tij	6 orë
• Promovimi i produkteve	5 orë
• Çmimi dhe llogaritja e tij	5 orë
<b>f) “Kontabiliteti në ekonominë bujqësore”, kl.12 dhe 13:</b>	<b>(60 orë)</b>
• Inventarët, format dhe llojet e tyre	6 orë
• Metoda e regjistrimit të dyfishtë dhe ditarët	6 orë

• Cikli kontabël dhe plani i llogarive	6 orë
• Llogaritë e rezultatit	8 orë
• Llogaritë e mallrave	8 orë
• Tatimi mbi vlerën e shtuar	9 orë
• Kontrolli i brendshëm dhe librat ndihmës	9 orë
• Mbyllja e bilancit përfundimtar vjetor	8 orë